



ALBANIA AND KOSOVO

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në dy dekadat e fundit, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë pësuar transformime të ndjeshme politike, sociale dhe ekonomike. Sidoqoftë, një numër sfidash të jashtëzakonshme mbeten kritike, ndër të cilat është integriteti i qeverisjes publike. Çështja e sundimit të ligjit në përgjithësi dhe antikorrupsioni në veçanti tani janë në zemër të projektit politik më konsekuent të Ballkanit Perëndimor – integrimi i tyre me organizatën kryesore të Evropës, Bashkimin Evropian. Kontributi i SELDI-it në axhendën antikorrupsion të Ballkanit Perëndimor ka qenë specifik dhe veprues, duke kërkuar të ndërtojë ura ndërmjet monitorimit, analizës dhe rekomandimeve të politikave.


Raporti Rajonal Antikorrupsion 2020 shqyrton kuadrin legjislativ dhe zhvillimet në praktikën e institucioneve shtetërore - ekzekutivin, legjislativin dhe gjyqësorin. Vlerësimi i faktorëve rregullatorë dhe institucionalë që mundësojnë korrupsionin në rajon nuk synohet si një inventar gjithëpërfshirës, por përkundrazi, thekson disa nga çështjet prioritare të rëndësishme për përpjekjet e mundshme për nxjerrjen në sipërfaqe të burimeve të përbashkëta të korrupsionit. Raporti ofron një model për raportimin e progresit antikorrupsion nga shoqëria civile në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Dinamikat e korrupsionit

Mjetet e monitorimit të SELDI-it ofrojnë të dhëna në lidhje me ndryshimet në përhapjen aktuale të dy llojeve të korrupsionit – korrupsionit administrativ (ryshfeti), i cili prek individët dhe bizneset, dhe kapjes së shtetit (korrupsioni i madh) që ndikon në funksionimin e institucioneve demokratike dhe në vendim-marrjen e qeverisë. Në lidhje me këtë të fundit, aplikimi i mjetit Diagnostikimi i Vlerësimit të Kapjes së Shtetit i SELDI-it (SCAD) në Ballkanin Perëndimor ka zbuluar se ekzistojnë rreziqe të konsiderueshme të kapjes së shtetit. **Presioni i kapjes së shtetit në rajon mbetet ende në nivele të larta.** Rezultatet tregojnë se asnjë nga vendet nuk është afër kapjes së plotë të shtetit, por ka cënime kritike në funksionimin e kontrolleve dhe të ekuilibrave demokratikë dhe ekonomikë.

Gjetete SCAD-it tregojnë praninë e fortë të **mundësuesve mjedisorë** siç janë organizatat publike jo-efektive, të cilave ju mungon integriteti, paanëshmëria dhe protokollat e fuqishme anti-korrupsion. Gjetjet, gjithashtu tregojnë simptoma aktuale të **presionit të kapjes së shtetit nga biznesi**, për shëmbull, monopolizimi që ndodh në nivel kombëtar, sektorial ose institucional. Presioni i monopolizimit është më i larti në Shqipëri dhe Kosovë.¹ Nivele të konsiderueshme janë regjistruar gjithashtu në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Serbi, në Maqedoninë e Veriut dhe në Malin e Zi. SCAD-i tregon simptomat e zhvillimeve të tilla në sektorët kryesorë ekonomikë. Një nga këta sektorë është energjitika, për shkak të niveleve të larta të përqendrimit, mungesës së transparencës dhe strukturës joefikase të qeverisjes së ndërmarrjeve shtetërore si dhe të mungesës së mbikëqyrjes së duhur rregullatore.

Nivelet e presionit të kapjes së shtetit në rajon janë të larta*




* Presioni i kapjes së shtetit të biznesit përqëndrohet në presionin e monopolizimit në nivelin kombëtar, sektorial ose institucional. Mundësiset e kapjes së shtetit përfshijnë faktorë institucionalë dhe mjedisorë në nivel kombëtar.

Burimi: SELDI SCAD, 2020.

Shkalla në të cilën korrupsioni tolerohet nga publiku i gjerë është një tregues i rëndësishëm i progresit të integritetit të zyrave publike. Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit (SMK) i SELDI-it, i cili mat format më të vogla të korrupsionit (ryshfeti), tregon se **pranueshmëria e korrupsionit mbetet relativisht e lartë** në Ballkanin Perëndimor. Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Kosova shfaqin pranueshmëri më të lartë se pjesa tjetër. Kjo, gjithashtu korrespondon me nivele të caktuara të presionit të korrupsionit – shumica dërrmuese (82%) e qytetarëve në rajon, që besojnë se korrupsioni është i pranueshëm në parim, presin që t'u kërkohej ryshfet. Edhe më e rëndësishmja, më shumë se gjysma (62%) e atyre që nuk e pranojnë korrupsionin si normë ende mendojnë se ka të ngjarë të bëhen viktima të presionit të korrupsionit.

¹ Emërtimi "Kosova" nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ) mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

Presioni i korrupsionit: pas një rënie të dukshme në mesin e viteve 2010, po rritet përsëri



Burimi: SELDI Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit, 2019.

Gjetjet e SMK-së tregojnë se në krahasim me 2016-ën presioni i korrupsionit në vitin 2019 u rrit në katër nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor: Bosnja dhe Hercegovina, e ndjekur nga Mali i Zi, Kosova dhe Serbia. Vetëm Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë pësuar një rënie të lehtë të presionit të korrupsionit. Këto rezultate tregojnë se vendet nën presion politik më të lartë nga BE dhe me një qëllim të qartë afatshkurtër në horizontin e tyre të pranimit në BE, kanë shfaqur një performancë më të mirë.

Legjislacioni antikorrupsion

Në gamën e mjeteve ligjore antikorrupsion, vendet e BP kanë arritur përparimin më të madh në zhvillimin e akteve ligjore, duke përfshirë fusha të tilla si parandalimi i konfliktit të interesit, mbrojtja e denoncuesve dhe kërkesat për deklarimet e pasurive nga zyrtarët publikë. Në përgjithësi, ata kanë **adaptuar standardet ndërkombëtare të anti-korrupsionit** në legjislacionet e tyre kombëtare, duke përfshirë dispozitat për pjesën më të madhe të veprave të detyrueshme të korrupsionit sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC), si dhe për disa jo të detyrueshme.

Aktivizmi rregullator në Ballkanin Perëndimor nuk ishte rezultat i një mekanizmi reagues për efektivitetin e politikave, por më tepër një përgjigje ndaj **kërkesës në rritje për integritet në qeverisje**, që vjen nga publiku vendas dhe partnerët ndërkombëtarë. Detyra tani për qeveritë kombëtare është të gjurmojnë shfaqjet dhe format e korrupsionit duke ruajtur stabilitetin rregullator dhe shmangien e mbingarkesës së gjyqësorit me ndryshime të shpejta të ligjeve në fuqi.

Një rast në fjalë është **prokurimi publik**. Gjatë tre viteve të fundit, ligjet mbi prokurimin publik janë rishikuar shpesh, duke treguar që politikat po përpriqen të ndjekin praktikën e ndryshme të këqija. Në Ballkanin Perëndimor, prokurimi publik është një zonë e rrezikut të lartë të korrupsionit pasi përdoret jo vetëm për të prokuruar mallra dhe shërbime për përfitim publik, por shpesh për të transferuar fonde publike në xhepat privatë. Vlerësimi i SELDI-it për prokurimin publik në vendet e BP zbulon se ai është veçanërisht i ndikuar

negativisht nga faktorë të tillë si: tendera shpesh të hartuara për të favorizuar pjesëmarrës të veçantë në tendera, mbikëqyrja e dobët mbi pajtueshmërinë dhe zbatimin e kushteve të kontratës, përdorimi i tepruar i procedurave me negociim pa shpallje publike, një numër i madh tenderash me një ofertë të vetme, etj.

Institucione të specializuara antikorrupsion

Krijimi i institucioneve ekzekutive me kompetenca ekskluzive antikorrupsion në mjedisin e kapjes së shtetit të vendeve të Ballkanit Perëndimor u përball me një dilemë: **shumë pak kompetenca do t'i bënin ato të padobishme**, gjë që do të rrisë më tej mosbesimin e publikut ndaj qeverisë; **shumë kompetenca, dhe ata rrezikojnë të bëhen mjete për qëllime politike partizane**. Vendet në BP janë përpjekur ta zgjidhin këtë dilemë në mënyra të ndryshme. Në Kosovë, ekziston vetëm një Zyrë e Mirë-Qeverisjes me tetë persona brenda Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, e cila monitoron hartimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike kundër korrupsionit. Në Shqipëri, gjithashtu nën autoritetin e Kryeministrit, ekziston një Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit. Në Serbi, angazhimi është më i hollësishëm: Agjencia Kundër Korrupsionit ka një detyrë mjaft të gjerë (monitorimi dhe bërja e politikave, zgjidhja e konfliktit të interesit, fillimi i ndryshimeve dhe miratimi i rregulloreve në fushën e anti-korrupsionit, koordinimi i organeve të tjera anti-korrupsion, etj.). Agjencia Malazeze për Parandalimin e Korrupsionit ka një mandat të gjerë të ngjajshëm - zbatimimi i masave për parandalimin e konfliktit të interesit, mbledhja dhe kontrolli i raporteve mbi pasuritë dhe të ardhurat e zyrtarëve publikë, marrja dhe veprimi i raporteve të sinjalizimit, etj. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, për shkak të strukturës së saj komplekse, ka 14 organe antikorrupsion në të gjitha nivelet e qeverisë dhe të gjithë ata janë krijuar me vendim zyrtar të qeverive ose parlamenteve dhe kanë juridiksionet e tyre.

Integriteti i shërbimit civil

Reformat që synojnë rritjen e integritetit të administratës publike në vendet e BP, të nxitura kryesisht nga Bashkimi Evropian dhe premtimi i pranimit në BE, kanë sjellë si rezultat që **të gjitha vendet kanë miratuar ligje të shërbimit civil**. Ekzistojnë mekanizma të ndryshëm për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në radhët e nëpunësve civilë. Për shembull, në Bosnje dhe Hercegovinë këto çështje rregullohen nga ligje të shumta dhe autonome për secilin nga nivelet e specifikuar të qeverisjes. Në Kosovë, nga ana tjetër, nuk ka dispozita specifike antikorrupsion në ligjin për nëpunësit civilë, por vetëm në Kodin e Sjelljes së Nëpunësve Civilë dhe ligjin antikorrupsion. Sidoqoftë, **zbatimi i këtyre**

mekanizmave dhe politikave represive mbetet mjaft i dobët dhe pa efekt të prekshëm, duke krijuar kështu terren pjellor që sjellja joetike të bëhet e pranueshme. Në të gjitha vendet e BP, nëpunësit e lartë civilë dhe veçanërisht disa kategori të veçanta të nëpunësve civilë të punësuar në sektorë me rrezik të lartë korrupsioni (policia, administrata tatimore, doganat, etj.) janë të detyruar të raportojnë pasuritë dhe të ardhurat e tyre në institucionet kompetente. Sidoqoftë, institucionet e ngarkuara me kontrollin e aseteve dhe të ardhurave janë përqëndruar kryesisht në zyrtarë publikë të zgjedhur, në vend të nëpunësve civilë. Pothuajse në të gjitha vendet ekziston një problem me largimet nga puna që anulohen nga gjykatat, duke treguar mangësi në zbatimin e uljeve në detyrë ose shkarkimin e nëpunësve civilë.

Vënia në jetë e antikorrupsionit: sistemi gjyqësor


Megjithëse reformat gjyqësore kanë vazhduar për më shumë se një dekadë në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, ato **nuk kanë prodhuar progres të rëndësishëm**. Thelbi i këtyre reformave ka qenë i kufizuar në përmirësimin e kornizës legislative dhe çështjeve të tjera teknike, pasuar nga zbatimi dhe performanca e dobët, veçanërisht në lidhje me ndjekjet penale dhe dënimet efektive – **dënimet përfundimtare të zyrtarëve publikë** mbeten kryesisht në një shifër të vetme. Kjo është veçanërisht e vërtetë për rastet e korrupsionit të nivelit më të lartë, megjithëse përjashtimet kanë filluar të shfaqen. Ndarja e pushteteve dhe krijimi i një gjyqësori të pavarur pengohen nga **politizimi i gjyqësorit, ndikimet e padrejta dhe korrupsioni** – pushteti legjislativ dhe ekzekutiv ende ushtrojnë një ndikim të fortë në procesin e zgjedhjes së gjyqësorit dhe në shpërndarjen e buxhetit. Të gjitha këto çështje paraqesin pengesa të mëdha në rrugën e pranimin në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Mangësitë kryesore në qeverisjen dhe funksionimin e gjyqësorit përfshijnë:

- ndikimi i degëve legislative dhe ekzekutive në përzgjedhjen dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe të prokurorëve;
- organet që qeverisin gjyqësorin dhe prokurorinë nuk janë të ndara siç duhet;
- zbatimi i përgjegjësisë disiplinore dhe kodeve të etikës për gjyqtarët dhe prokurorët është akoma shumë i kufizuar;
- zyrrave të prokurorive publike u mungojnë burimet, veçanërisht ekspertiza në kriminalistikën financiare;
- strukturat manaxheriale janë të paqarta dhe kompetencat shpesh mbivendosen.

Antikorrupsioni në ekonomi: sektori informal

Një **sektor i rëndësishëm i ekonomisë informale** i lidhur ngushtë me korrupsionin vazhdon të shqetësojë Ballkanin Perëndimor. Prania e këtij sektori mund t'i atribuohet një numri të madh shkaqesh, të tilla si morali i ulët tatimor; mjedis i dobët i biznesit dhe nivelet shumë të larta të varfërisë; mungesa e besimit në institucionet e qeverisë dhe perceptimi i lartë i korrupsionit; taksimi dhe kostot e larta para-fiskale, paralelisht me politikën tatimore tepër shtrënguese; inspektime dhe kontrolle të pamjaftueshme; burokraci, sistemi i pagesave të rënda të ndërprerjeve të marrëdhënieve të punës dhe ndryshimet e shpeshta të legjislacionit.

Punëtorët pa kontratë të shkruar në punën kryesore ose që marrin shpërblim më shumë se sa deklarohet (2019, në %)



Burimi: SELDI Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit / Sistemi i Monitorimit të Ekonomisë Informale, 2020.

Toleranca e lartë ndaj evazionit të kontributeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore është kultivuar në Ballkanin Perëndimor për shkak të perceptimit se autoritetet tatimore, dhe në përgjithësi sistemi publik janë të korruptuar. Sipas 45.7% të bizneseve në Maqedoninë e Veriut dhe 72.9% në Shqipëri, korrupsioni është faktori më i rëndësishëm për ekzistencën e ekonomisë informale. Kjo e bën publikun të besojë se taksat nuk përdoren si duhet për ofrimin e shërbimeve më të mira publike.

Politikë-bërësit e Ballkanit Perëndimor kanë ndërmarrë hapa për të nxitur **përdorimin e detyrueshëm të kontratave të shkruara** në punën kryesore, por përpjekjet e tyre kanë mbetur kryesisht të pasuksesshme, pasi nivelet e përgjithshme të ekonomisë informale vazhdojnë të rriten. Kjo është për shkak të mënyrave të shumta alternative të shmangies së pagesës së kontributeve shëndetësore dhe shoqërore, të tilla si nëndeklarimi i shumës së pagës së marrë, ose mosdeklarimi i punëve dytësore ose me kohë të pjesshme.

Roli i shoqërisë civile

Në të gjithë Ballkanin Perëndimor, **organizatat e shoqërisë civile (OSHC) kanë rritur ekspertizën dhe aftësinë e tyre** për të përdorur këtë ekspertizë në një sërë kontributesh në agjendën antikorrupsion. Ndikimi i tyre kundër korrupsionit arrihet përmes një larmie mjjetesh – inicimi i ndryshimeve legjislative dhe standardeve për praktikën e mira për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe integritetin e ndërmarrjeve publike dhe rritjen e kapacitetit të biznesit privat për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin.

Duke pasur parasysh rolin e tyre aktiv në promovimin e integritetit të zyrës publike, është akoma më e përshtatshme që **OSHC-të të mbahen sipas standardeve më të larta të transparencës dhe llogaridhënies**. Në përgjithësi, ndërsa një numër në rritje i OSHC-ve avokojnë për mirëqeverisjen, ka pak përparim në marrjen e hapave për t'u bërë vetëmë transparente. Një masë e qartë e kësaj është numri i ulët i OSHC-ve që publikojnë në Internet raporte vjetore. Në disa vende (p.sh., në Bosnje dhe Hercegovinë), nuk ka ndonjë kërkesë specifike për OSHC-të që të publikojnë raporte operacionale dhe financiare - ligji kërkon që ato të jenë «transparente» pa përcaktuar ndonjë specifikë. Në praktikë, vetëm OSHC-të që aplikojnë për fonde të qeverive janë të detyruara të sigurojnë rregullisht raporte.

Rruga përpara: katalizimi i antikorrupsionit në Ballkanin Perëndimor

Përparimi i ngadaltë dhe i papërfillshëm i antikorrupsionit ka lejuar që interesat private të marrin një kontroll mbi qeveritë e Ballkanit Perëndimor duke rezultuar në kapjen e shtetit. Lirimi i qeverisjes nga ky kontroll mund të arrihet vetëm nga një aleancë e palëve të interesuara që veprojnë në bashkëpunim: **politikëbërës me mendje-reformuese, shoqëri civile dhe partnerë ndërkombëtarë**, kryesori ndërmjet të cilëve Bashkimi Evropian.

Në nivel kombëtar, është e nevojshme që organet publike në Ballkanin Perëndimor të krijojnë **procedura për ndjekjen penale efektive** të politikanëve të korruptuar të nivelit të lartë dhe nëpunësve të lartë civilë. Analiza e të dhënave të SCAD sugjeron që një përparësi kryesore duhet të jetë ruajtja dhe monitorimi i pavarësisë dhe performancës së gjyqësorit. Ndikimi i degëve legjislative dhe ekzekutive në përzgjedhjen dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet normalisht të përjashtohet ose minimizohet. Vendet ku shumica e organeve të vetëqeverisjes gjyqësore nuk zgjidhen midis gjyqtarëve dhe nga gjyqtarët, duhet të miratojnë reforma duke rritur fuqinë e tyre të votimit.

Një **ekuilibër i duhur midis parandalimit dhe shtypjes** është veçanërisht i rëndësishëm për t'u arritur kur kërkohet të zvogëlohet madhësia e ekonomisë informale dhe ndikimi i saj në korrupsion. Qeveritë duhet të identifikojnë stimujt që nxisin punëdhënësit dhe punonjësit të angazhohen në aktivitete informale të biznesit; këto më pas do të faktorizoheshin gjatë hartimit të reformave për përmirësimin e mjedisit të biznesit, politikës tatimore dhe të cilësisë së shërbimeve publike.

Një çështje kritike për të siguruar që qeveritë të mbajnë përgjegjësi është **transparenca e pronësisë së medias**, pavarësia e redaksisë dhe ruajtja e lirisë së medias nga ndërhyrjet politike. Një fokus i veçantë në përpjekjet e qeverive duhet të jetë shmangia e kapjes së shoqërisë civile, përmirësimi i qeverisjes së ndërmarrjeve shtetërore dhe menaxhimi transparent i projekteve të investimeve në shkallë të gjerë.

Përparimi i cilësisë së qeverisjes publike në vendet e Ballkanit Perëndimor tani është i lidhur ngushtë me procesin e integritetit të tyre në Bashkimin Evropian. Kushtet themelore, të cilat ndikojnë në reformat e integritetit, janë të ndryshme në secilin vend, duke e bërë BE-në faktorin rajonal stabilizues për këto reforma.

Që strategjia e saj e zgjerimit ta lejojë atë të vazhdojë të jetë një faktor i tillë, **BE ka nevojë për një angazhim politik** më aktiv me vendet e Ballkanit Perëndimor, duke u siguruar atyre një perspektivë të qartë për të ardhmen. Sidoqoftë, angazhimi më i fortë do të duhet të ruhet nga disa pasoja të padëshiruara, të cilat mund ta bëjnë atë joproduktiv. Do të ishte e nevojshme për t'u siguruar që përfitimet e integritetit më të afërt ekonomik me Unionin, nuk i takojnë ekskluzivisht një klike të vogël oligarkësh të privilegjuar, duke përkeqësuar kështu më tej kapjen e shtetit të biznesit. Kushtëzimet e lidhura me anëtarësimin mbi integritetin e qeverive duhet të shoqërohen paralelisht nga kërkesa publike lokale po aq e fortë për llogaridhënien, që aktorët politikë dominues të mos e zgjedhin të parin si një justifikim për të [diskredituar / shpërfillur] të dytën. Gjithashtu, angazhimi në arenën diplomatike me politikanët dhe zyrtarët e lartë të qeverisë do të duhet të kryhet në një mënyrë që të mos krijojë përshtypjen e mbështetjes politike. Efekti i përgjithshëm i këtij procesi duhet të jetë përballimi dhe **neutralizimi i efekteve të dëmshme të ndikimit autoritar** në rajon.

Bashkimi Evropian tani ka forcuar modifikimet e sjelljes gjatë procesit të zgjerimit duke futur kushtëzim negativ dhe pozitiv dhe duke përfshirë mundësi të tilla si **pezullimi i negociatave dhe ngrirja e fondeve**. SELDI mirëpret përfshirjen në qasjen e BE-së për antikorrupsionin në kontekstin e pranimit të disa prej rekomandimeve të mëparshme të SELDI-it, duke

përfshirë integrimin e antikorrupsionit në një gamë më të gjerë të politikave dhe jo vetëm në institucionet antikorrupsion dhe gjyqësorin dhe mbrojtjen e marrëdhënieve të rëndësishme KE–shoqëri civile, përfshirë mbështetjen e tyre financiare nga ankthi i të papriturave. Akoma, përparësia e axhendës së sundimit të ligjit për përparimin në çdo fushë tjetër të zhvillimit të Ballkanit Perëndimor duhet të theksohet më tej, veçanërisht nëpërmjet zgjerimit të gamës së aktorëve të përfshirë në monitorimin dhe nëavokimin për reformat e qeverisjes së mirë. Vetëm një **koalicion publik-privat** që përfshin të dyja institucionet, edhe aktorët e BE-së dhe institucionet lokale publike dhe private si dhe individët do të ishin në gjendje të sigurojnë premisën e zhvillimeve pozitive antikorrupsion, d.m.th., pakthyeshmërinë e tyre.

Asistenca antikorrupsion e BE-së – si teknike ashtu edhe financiare - për Ballkanin Perëndimor duhet të sigurohet në sinkron me mesazhet e politikës së përgjithshme të BE-së. Kjo është ajo që pritet tani nga Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) III. Duke patur parasysh gjetjet e vlerësimit SCAD të SELDI-it për intensitetin e kapjes së shtetit në rajon, **fondet e BE-së duhet të përfshijnë parimin *primum non no cere* (së pari, mos bëj dëm)**. Me fjalë të tjera, ajo duhet të sigurojë që ajo të mos bëhet joproduktive duke forcuar rrjetet klienteliste të politikanëve të korruptuar dhe të bizneseve të privileguara që marrin pjesën më të madhe të prokurimeve të financuara nga BE.

BE duhet të vazhdojë të monitorojë zhvillimet antikorrupsion në partneritet me shoqërinë civile në rajon. Mekanizmat e pavarur të monitorimit të korrupsionit dhe antikorrupsionit janë të nevojshëm në të gjitha nivelet – nga vlerësimi i politikave të riskut të korrupsionit në leximin e provave të legjislacionit kryesor dhe analizimi i efikasitetit të procedurave të brendshme antikorrupsion në institucionet individuale publike. Duke ndihmuar vendet të merren me këto të fundit, BE do të këshillohej mirë nëse do të përfshinte **instrumente novatore analitike** për të drejtuar politikën e saj, të tilla si ato të pilotuara nga SELDI:

- Instrumenti i *Monitorimit të Zbatimit të Politikave Antikorrupsion* (MACPI), i cili vlerëson rezistencën e korrupsionit të institucioneve dhe identifikon politikën antikorrupsion dhe boshllëqet e zbatimit; dhe
- *Diagnostikimi i Vlerësimit të Kapjes së Shtetit* i cili ndihmon në identifikimin e dobësive të kapjes së shtetit.

Komisioni Evropian do të duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë ruajtjes së konkurrencës në **sektorë me presion të lartë të monopolizimit** gjatë zbatimit të planit të investimeve për rajonin. Mbështetja teknike, këshillat e politikave dhe fondet e BE duhet të drejtohen

drejt përpjekjeve antikorrupsion dhe antimonopol të përqendruara në sektorë kritikë, siç janë **energja, infrastruktura, bankat dhe tele-komunikacioni**. Shtirja e **misioneve këshillimore** në të gjithë Ballkanin Perëndimor do të përfitojë gjithashtu nga kryerja e vlerësimeve të sundimit të ligjit; megjithatë, rekomandohet që në vlerësimin profesional të rasteve, të përfshihen **ekspertë të shoqërisë civile**. Komisioni Evropian dhe Delegacionet lokale të BE-së duhet të punojnë së bashku me palët e interesit lokal për të vendosur procedurat për monitorimin e rregullt të gjykimit të rasteve të korrupsionit, si dhe monitorimin e progresit të reformave gjyqësore.